



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:027995

Datë: 28.10.2022

Numri i dokumentit: 03583481

CP.nr.102/2022

Gjykata Themelore Gjilan dega e Vitisë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, duke vendosur në çështjen juridike përmbareme të kreditores V.RR.T.. nga fsh P.. Komuna Viti , të cilin e përfaqëson Fatos Pira, avokat në Viti ndaj debitorit Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit ditor, në shume prej 2.546.00 euro, gjykata jashtë seancës gjyqësore më datë 28.10.2022 bie këtë:

A K T V E N D I M

Përfundohet, procedura përmbareme e kreditores V.RR.T.. nga fsh P.. Komuna Viti, të cilin e përfaqëson Fatos Pira, avokat në Viti, në këtë çështje juridike përmbareme.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Gjilan dega e Vitisë, kishte lejuar propozimin me nr. CP.nr. 102/2022, të datës 09.02.2022, ndaj kreditores V.RR.T.. nga fsh P.. Komuna Viti, të cilin e përfaqëson Fatos Pira, avokat në Viti, kundër debitorit Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit ditor, në shume prej 2.546.00 euro, sipas dokumentit përmbareme akgykimi C.nr. 562/2020 të datës 23.11.2021.

Gjykata me datën 21.09.2022, kishte pranuar parashtresën nga ana e të autorizuarit së kreditores, nga e cila parashtresë ishte konfirmuar se debitori e ka përmbushur detyrimin në tërsi .

Gjykata pas vlerësimit të parashtresës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të përfundohet procedura përmbareme ndaj debitorit duke u bazuar në parashtresën e paraqitur, pranë kësaj Gjykate.

Pasi që gjykata ka konstatuar se debitori e kishte përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, gjykata konform nenin 42 paragraf.2 dhe 66 paragraf. 4 të LPP-ës, ka përfunduar procedurën duke vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi

Numri i lëndës: 2022:027995
Datë: 28.10.2022
Numri i dokumentit: 03583481

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 66 par.4 të LPP-së, dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:027995, 28.10.2022**

Gj y q t a r i
Alush Sinani

Udhëzimi mbi Mjetin Juridik : kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, 7 ditë pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.